



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 29

Prishtinë, më 06.07.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Selvie Halimi, Agim Aliu, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Agim Ademaj dhe Donika Kadaj-Bujupi.

Munguan: Albulena Haxhiu, Doruntinë Maloku, Danush Ademi, Fatmir Limaj dhe Milena Miliceviq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Liridon Sadiku – IKPZH, Blerta Gashi – Rrokum TV, Florina Merovci, ZPRK, Jelena Gjorgjeviq – RTK 2, Petrit Hysaj – OSBE, Kaltrina Ahmeti dhe Tringa Bytyqi – GLPS, Norë Shabani – Koha ditore, Valmire Hoti – Infodirekt. TV, Amire Qamili – BIRN, Blerta Bejtullahu – EUSR/Eu Office, Hamit Mjeku dhe Zahir Çerkini-praktikantë në Kuvend.

Mbledhjen e kryesoi, Selvije Halimi, nënkryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 05/L-29 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave;
3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 05/L-28 për Tatimin në të Ardhurat Personale;
4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 05/L-37 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar;

5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L-027 për digjitalizimin e transmetimeve radio- difuzive tokësore;
6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L-22 për Armë;
7. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L-15 për Letërnjoftim;
8. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 03/L-246 për Pajisje me Armë, Municion dhe Pajisje Përkatëse të Sigurisë për Institucionet e Autorizuara Shtetërore për Siguri;
9. Procedimi i Projektligjit për Kuvendin e Republikës së Kosovës;
10. Votimi i Raportit vjetor i punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për vitin 2014;
11. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

***Kryesuesja** propozoi që pika shtatë të hiqet nga rendi i ditës pasi duhet kohë për konsultime shtesë, meqë për këtë Projektligj ka vërejtje edhe Komisioni për Integritet Evropian.*

Rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.

2. Shqyrtimi i raporteve me amendamente i komisioneve funksionale

***Kryesuesja** propozoi që të aprovohen në pako pikat 2,3,4,5,6 dhe 8 pasi në këtë fazë ne shikojmë vetëm pajtueshmërinë me kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm dhe vlerësoi se nuk ka ndonjë pengesë që të procedohen tutje.*

Meqë nuk kishte vërejtje Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

Rekomandim

I. Projektligjet:

Projektligji nr. 05/L-29 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave;
 Projektligji nr. 05/L-28 për Tatimin në të Ardhurat Personale;
 Projektligji nr. 05/L-37 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar;
 Projektligji nr. 05/L-027 për digjitalizimin e transmetimeve radio- difuzive tokësore;
 Projektligji nr. 05/L-22 për Armë; dhe
 Projektligji nr. 03/L-246 për Pajisje me Armë, Municion dhe Pajisje Përkatëse të Sigurisë për Institucionet e Autorizuara Shtetërore për Siguri, janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

II. Projektligjet dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

3. Procedimi i Projektligjit për Kuvendin e Republikës së Kosovës;

Armend Zemaj, në cilësi të kryesuesit në Nënkomision tha se tani janë plotësuar kushtet për procedim të projektligjit për mendim në Qeveri pasi që kemi shkresat përcjellëse, si

memorandumin shpjegues, deklaratën financiare dhe është i përkthyer në tri gjuhë. Më tutje shtoi se meqë jemi pajtuar për përmbajtjen e Projektligjit, propozoi që në formulimi për rezolutën në nenin 5 të jetë si vijon: “ Kuvendi me Rezolutë tregon gjendjen dhe problemet në një fushë të caktuar dhe masat që duhet të ndërmerren. Rezoluta është akt detyrues dhe miratohet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.”

Ai po ashtu propozoi që formulimi për rekomandimin të jetë “Kuvendi me rekomandim shpreh pikëpamjet dhe paraqet propozimet për punën e organeve shtetërore dhe publike dhe kërkon zbatimin e tyre.

Meqë nuk kishte vërejtje të tjera Komisioni vendosi që Kryesisë së Kuvendit t’ia dërgojë Projektligjin për procedim të mëtejshëm.

4. Votimi i Raportit vjetor i punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për vitin 2014.

Kryesuesja tha për Raportin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për vitin 2014 kemi diskutuar dhe në këtë mbledhje ka mbetur vetëm të votohet, pasi në mbledhjen e kaluar nuk kishte kuorum për të vazhduar me votimin e këtij raporti.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni me shumicë votash, vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë

Rekomandim

Të miratohet Raporti i punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për vitin 2014.

5. Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë nuk kishte diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit

Nënkryetarja e Komisionit,

Selvije Halimi